



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrimit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-274/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Decis Expert i prodhuesit “Bayer AG”, Gjermani, nga përfaqësuesi i saj “Agromarket KS” Prishtinë.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Insekticid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Delthametrin.....100g/l

4. PËRDORIMI:

PËRDORIMI:

Decis Expert është insekticid me veprim kontakti dhe digjestiv të shpejtë, me spektër të gjere veprimi i destinuar për kontrollin e insekteve të dëmshme në kulturën e grurit dhe misrit.

Decis Expert përdoret në këto kultura:

1) **Grurë**, për kontrollin e ushunjzës së drithërave (Lema melanopus), sasia e përdorimit 0.075l/ha(0.75ml/100m²) dhe sasia e ujit të shpenzuar nga 200-400l/ha(2-4l/m²) pas paraqitjes së dëmeve të para dhe staveve të reja të larvave të insekteve;

2) **Misër**, për kontrollin e krimbit të misrit (*Ostrinia nubilalis*), sasia e përdorimit 0,075-0,125l/ha (0,75-1,25ml/100 m²) dhe sasia e ujit të shpenzuar nga 200-400l/ha duke trajtuar 10 dite pas fluturimit maksimal të fluturave apo me paraqitjen e staveve të reja të larvave të insekteve.

3) **Jonxhe**, për kontrollin e gjethengrënësit të jonxhës (*Phytodecta fornicata*) sasia e përdorimit 0,05-0,075l/ha, trajtimi pas paraqitjes së insektit të rritur me sasi të ujit të shpenzuar nga 200-400l/ha

4) **Kolëz**, për kontrollin e lulengrënësit të kolzes (*Meligethes aeneus*) në sasi prej 0,075l/ha, trajtimi në kohën e paraqitjes së insektit të rritur kur lulja kryesore është e dukshme por ende e mbyllur-deri në hapjen e luleve të para (50-60 BBCH shkalla) sasia e ujit të shpenzuar 200-400l/ha.

5) **Luledielli**, për luftimin e morrave të bimëve (*Aphididae*) në sasi aplikimi 0,075l/ha konsum të ujit 200-400l/ha, më trajtim pas paraqitjes. Numri maksimal i trajtimeve është një here.

6) **Vishnja**, për luftimin e mizave të qershisë *Rhagoletis cerasi* në sasi aplikimi 0,175l/ha dhe konsum të ujit 1000l/ha. Trajtimet kryhen në kohën e fluturimit masiv, para ndërrimit të ngjyrës së frytit (fenofaza BBCH 80), me spërkatje ose në formë vese. Numri maksimal i trajtimeve është një here.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

100ml; 500ml, 1L, 5L

6. VËREJTJE:

Nuk lejohet të aplikohet në kohën e fluturimit të bletëve.

7. KARENCA:

Koha në mes trajtimit të fundit dhe vjeljes përkatësisht korrijes: Gruri 35 dite, misër 30 dite, jonxhë 14, kolëz 42 dite, luledielli 60 dite, vishnje 7 dite.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

ambient



GHS09 - paralajmërim (cat 1)-i rrezikshëm për



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS08-i dëmshëm për shëndetin



GHS03- oksidues



GHS05-paralajmërim për rrezikun-ndryshku

9. Vendi i shitjes: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Faton Peci

Ministër

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.